ANALIZË

SI TË VIJMË DERI TEK MBROJTJA MË EFEKTIVE NGA PADITË STRATEGJIKE KUNDËR PJESËMARRJES NË PUBLIK (SLAPP)?

TETOR 2023

Shoqata e Gazetarëve
të Maqedonisë

Titulli: ANALIZË - Si të vijmë deri tek mbrojtja më efektive kundër padive strategjike kundër pjesëmarrjes në publik (SLAPP)?

Projekti: "Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) janë një shuplakë për qytetarët dhe interesin publik"

Zbatuesi: Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

E mbështetur nga: UNESCO's Global Media Defence Fund (GMDF) – (Fondi Global i i UNESCO-s për Mbrojtjen e Medias)

Programi: Global Campaign for Media Freedom and the UN Plan of Action on the Safety of Journalists and the Issue of Impunity – (Fushata Globale për Lirinë e Medias dhe Plani i Veprimit i OKB-së për Sigurinë e Gazetarëve dhe Çështjen e Mosndëshkimit)

Redaktor: Dragan Sekullovski

Autorë: Dr. Zharko Aleksov dhe Mr. Zharko Haxhi-Zafirov

© TETOR, 2023

Indikacionet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehjen e çfarëdo mendimi nga UNESCO-ja në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti apo zone ose të autoriteteve lokale të atjeshme apo në lidhje me përcaktimin e kufijve.

Autorët janë përgjegjës për përzgjedhjen dhe prezantimin e fakteve të përfshira në këtë publikim dhe, për mendimet e shprehura të cilat nuk janë domosdo ato të UNESCO-s, nuk janë të detyrueshme për Organizatën.

With the support of the
UNESCO Global Media Defence Fund (GMDF)

Shoqata e Gazetarëve

PËRMBAJTJA

1. Tabela me akronime	6
2. Hyrje	7
2.1 Struktua e analizës	7
2.2 Cili është qëllimi i kësaj analize?	8
2.3. Qasje metodologjike	8
3. Çfarë është padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP)?	9
3.1 Definim i termit **SLAPP**	9
3.2 SLAPP nëpërmjet numrave – shembulli Evropës	12
3.3 Cilat janë viktimat më të shpeshta të SLAPP?	13
3.4 Cilat janë bazat më të shpeshta të SLAPP?	13
3.5 Cili është paditësi dhe parashtruesi më i shpeshtë SLAPP?	14
4. Rasti i Maltës dhe lindja e "Ligjit të Dafnes"	14
5. Ligje kundër SLAPP	15
5.1 Draft – Direktiva e propozuar nga Komisioni Evropian	16
5.2. Draft - Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për të kundërshtuar përdorimin e SLAPP	17
5.3 A ekziston nevoja për të bërë dallim mes mbrojtjes së gazetarëve dhe aktorëve të tjerë	20
6. Rishikim i kornizës relevante ligjore kundër SLAPP në RMV	21
6.1 Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut	21
6.2 Ligje	21
6.2.1 Ligji për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje	21
6.2.1.1 Zhvendosja e barrës së dëshmisë	22
6.2.1.2 Mekanizma mbrojtjes në rastet e SLAPP	22
6.2.2 Ligji për Detyrimet (LD)	23
6.2.3 Ligji për sigurimin e kërkesave	24
6.2.4 Ligji për procedurë civile	24
6.3 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në luftën kundër SLAPP	25

6.3.1 Përjashtime nga liria e shprehjes sipas GJEDNJ	25
6.3.2 Fragmente nga praktika e GJEDNJ që janë relevante për SLAPP	26
6.3.3 Shembuj të SLAPP në botë dhe rajon	29
6.4 Lëndë SLAPP në gjykatat kombëtare	31
7. Intervista me palë relevante	34
8. Konkluza dhe gjetje nga intervistat e realizuara	37
9. Rekomandime për veprim në rastet e SLAPP, nga aspekti ligjor dhe praktik	37
9.1 Indikatorë për identifikimin e SLAPP	37
9.2 Udhëzime të përgjithshme dhe rekomandime për mbrojtjen nga SLAPP	39
10. PLOTËSIM	43

LIRIA e shtypit,
nëse kjo vlen diçka,
është LIRI për të kritikuar
dhe kundërshtuar

Xhorxh Orvel

1. TABELË ME AKRONIME

1.	SLAPP	Padi strategjike kundër pjesëmarrjes në publik
2.	GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
3.	CASE	Koalicioni kundër SLAPPc në Evropë
4.	OJQ	Organizata Joqeveritare
5.	SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
6.	BE	Bashkimi Evropian
7.	KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
8.	LPC	Ligji për Procedurë Civile
9.	LD	Ligji për Detyrimet
10.	LPCOSH	Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje
11.	КРИК	Rrjet për hulumtim të krimit dhe korrupsionit në Serbi
12.	AIS	Agjencia informative dhe e sigurisë në Serbi

2. HYRJE

Kjo analizë është përpiluar në kuadër të një projekti që përfshin gazetarë dhe punonjës të medias, komunitetin mediatik dhe institucionet përkatëse, qëllimi i së ciliës është të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit për rrezikun që paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) paraqesin për lirinë e shprehjes, përmes mjeteve parandaluese, të cilat do të edukojnë palët e interesuara.

2.1 Struktura e analizës

Analiza përbëhet nga tre pjesë integrale.

Pjesa e parë trajton përkufizimin e SLAPP dhe elementet thelbësore të këtij fenomeni, duke përfshirë një pasqyrë të shkurtër të situatës SLAPP në Evropë.

Pjesa e dytë fokusohet në hartimin dhe vlerësimin ligjor të legjislacionit kombëtar për të siguruar një sistemim të qartë të legjislativit përkatës, në lidhje me mekanizmat ekzistues të mbro-

jtjes kundër SLAPP. Në të njëjtën kohë, ky seksion i referohet edhe parimeve që qëndrojnë në themel të mbrojtjes nga SLAPP, të cilat rrjedhin nga praktika e GJEDNJ. Autorët bënë përpjekje për të përzgjedhur dhe analizuar disa raste mbi temën në diskutim. Gjuha e përdorur në këtë seksion është e qartë dhe e thjeshtë, duke ruajtur saktësinë ligjore dhe konsistencën e argumentimit të GJEDNJ.

Pjesa e tretë ka të bëjë me vendosjen e udhëzimeve për përcaktimin e padive strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut në kontekstin lokal, kjo përmes studimeve të rasteve nga vendi dhe nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, për të inkurajuar të mësuarit dhe shkëmbimin, si dhe rekomandimet ligjore të rëndësishme për kontekstin lokal, me qëllim njohjen dhe parandalimin dhe përmirësimin e mbrojtjes ligjore të gazetarëve.

2.2 Cili është qëllimi i kësaj analize?

Analiza në vazhdim ka dy qëllime:

1. Të jetë një lloj udhërrëfyesi mbi udhëzimet për përcaktimin e padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) në kontekstin lokal. Ky synim është i lidhur ngushtë me një nga synimet e veçanta të projektit për të rritur kapacitetet, njohuritë dhe aftësitë e gazetarëve, aktivistëve, analistëve, juristëve dhe organizatave të shoqërisë civile në njohjen e SLAPP dhe të pasurit një rol proaktiv në zbulimin dhe luftimin e këtij fenomeni;

2. Qëllimi i dytë i analizës është të rrisë ndërgjegjësimin, jo vetëm të gazetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, por edhe të publikut më të gjerë, për rrezikun që kanë paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) për lirinë e shprehjes publike të mendimit, lirisë së fjalës, të folurit publik dhe informimit publik.

2.3 Qasja metodologjike

Të dhënat në këtë analizë janë dokumentuar duke përdorur metodën e analizës dhe sintezës me një përshkrim të detajuar dhe prezantim piktoresk të rezultateve të hulumtimit. Kombinimi i metodave krahasuese me ato përshkruese është përdorur gjatë zbatimit dhe përshkrimit të kornizës ligjore, praktikës së GJEDNJ, dhe intervistave të realizuara që ishin të nevojshme për vërtetimin e udhëzimeve për definimin e SLAPP.

METODOLOGJIA

2. AKTIVITETE HULUMTUESE

Zbatim i intervistave konsultuese lidhur me problemet dhe sfidat e gazetarëve, që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe gjendjen me SLAPP.



1. ANALIZË E DOKUMENTEVE RELEVANTE

Definimin e SLAPP, analizimin e akteve/dokumenteve vendore dhe ndërkombëtare, analizë e rasteve në vend, Ballkan dhe BE.

3. PËRGATITJA E UDHËZIMEVE

Përgatitja e udhëzimeve për definim të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike në kontekst lokal dhe nëpërmjet studimit të rasteve.

3. ÇFARË ËSHTË PADIA STRATEGJIKE KUNDËR PJESËMARRJES PUBLIKE (SLAPP)?

3.1 Definim i termit SLAPP

Termi SLAPP – Padia strategjike kundër pjesëmarrjes publike – fillimisht është vendosur nga profesorët Xhorxh V. Pring, dhe Penelope Kanan në librin e tyre ***"SLAPPs: Getting Sued for Speaking Out (1996)"*** [1]**.** Termi në përgjithësi ka të bëjë me padi të parashtruara nga persona ose subjekte të fuqishme, respektivisht entitete (për shembull korporata, funksionar publik, person afarist i profilit të lartë) kundër organizatave civile apo individëve, siç janë gazetarët apo të tjerë, që kanë shprehur ndonjë qëndrim kritik për çështje thelbësore me ndonjë interes politik apo rëndësie shoqërore.[2]

Përcaktimi se çfarë është një SLAPP mbetet një nga qëllimet më të pamundura të të gjithë legjislacionit kundër këtij fenomeni. A është e tepërt të pritet që duhet të ketë disa përpjekje për konsistencë përkufizimi midis tre organeve evropiane (përfshirë qeverinë tonë) në mënyrë që të ndihmohen avokatët të cilët në të ardhmen mund ta gjejnë veten në dilema për mënyrën më të mirë për të vepruar në këtë fushë komplekse?[3]

1 Pring and Cannan, SLAPPs: Getting Sued for Speaking Out (1996) https://books.google.mk/books?id=SEaAjENdpJkC&printsec=frontcover&source=gbs_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false

2 European Centre for Press and Media Freedom: https://www.ecpmf.eu/slapp-the-background-of-strategic-lawsuits-against-public-participation/

3 The Law Society Gazette, https://www.lawgazette.co.uk/commentary-and-opinion/three-types-of-slapps/5116441.article

Sipas mendimit ligjor amerikan, SLAPP është diçka ndryshe nga një sulm i "thjeshtë" ndaj fjalës së lirë: SLAPP synon të ndalojë fjalimin kritik, duke frikësuar kritikët dhe duke shteruar burimet e tyre, duke minuar angazhimin e tyre aktiv publik. Për më tepër, një karakteristikë themelore e këtij lloji të padisë është pabarazia e pushtetit dhe burimeve ndërmjet paditësit dhe të paditurit.

SLAPP nuk vlen vetëm për gazetarët. SLAPP mund të aplikohet edhe kundër organizatave të shoqërisë civile, analistëve, avokatëve, figurave publike, pra në thelb kundër kujtdo që mund të ngrejë një debat publik ose të ngrejë një çështje të caktuar që prek interesin publik. Në thelb, fenomeni SLAPP nuk është aq i thjeshtë për t'u përshkruar apo përcaktuar, duke pasur parasysh faktin se treguesit imanent ndaj tyre nuk janë gjithmonë të qartë dhe të dukshëm.

Shpesh, këto lloj padish janë të pabaza ose ofenduese, të maskuara si padi për shpifje ose shkelje të pretenduar të të drejtave kushtetuese dhe/ose civile, të cilat ngrihen kundër gazetarëve ose aktivistëve për ushtrimin e të drejtave të tyre politike dhe/ose lirinë e tyre të shprehjes dhe informimit në lidhje me çështje me interes publik ose me rëndësi shoqërore.

Ato zakonisht nuk ngrihen për të fituar drejtësi, por për të frikësuar, heshtur dhe shteruar burimet financiare dhe psikologjike të objektivave të SLAPP. Ato karakterizohen shpesh nga një pabarazi e madhe e pushtetit midis paditësit dhe të paditurit, ku njëri ka burimet dhe aftësinë për të heshtur në mënyrë efektive tjetrin nëpërmjet teknikave gjyqësore që përforcojnë barrën psikologjike dhe ekonomike të procedimeve të zgjatura.[4]

Një SLAPP synon shterjen e burimeve të të paditurit, duke përfshirë motivimin për të vazhduar punën në një storje të caktuar, projekt ose në mbledhjen e informacionit në mënyrë që të prezantohen më tej në publik.

Një nga karakteristikat më domethënëse të këtyre veprimeve shihet përmes efektit të tyre që ata duan të arrijnë. Subjektet e fuqishme politike, biznesore apo shoqërore, që nisin këto procese gjyqësore, nuk janë aq të motivuar nga shuma e dëmshpërblimit që do të arrinin, por janë të motivuar që të mos ngrenë fare një çështje nëpër institucionet. E ku theksohen më mirë çështjet që këto subjekte nuk do të donin të diskutoheshin, sesa para gjykatave, ku palët janë të barabarta dhe paraqiten provat pro dhe kundër. Efekti përfundimtar i këtyre padive është në fakt arritja e këtij efekti parandalues, pra "efekti ftohës" ndaj të paditurit/ve, për të penguar funksionimin normal të tyre, jo vetëm të së drejtës biznesore, por edhe private.

Siç është nënvizuar nga Raportuesi Special për të drejtat e lirisë së tubimit dhe organizimit paqësor, mjedisi i një vendi të caktuar mund të jetë arsyeja për mjedis më shumë apo më pak i përshtatshëm për SLAPP. Varet nga një sërë faktorësh, ai jo se sa janë të larta harxhimet juridike, elasticiteti

4 Rafał Mańko Members' Research Service PE 733.668, SLAPP- BRIEFING EU Legislation in Progress, July 2023

i ligjeve që synojnë fjalën (veçanërisht shpifjet) dhe ekzistenca e masave mbrojtëse (p.sh. statutet anti-SLAPP (rregullore) apo shpërblimet për harxhime në rast abuzimi të procesit). Për shembull, këto tre kërkesa plotësohen në mënyrë të përkryer në kontekstin amerikan: për këtë arsye, grupi i fjalës së lirë, Indeksi i Censurës, ka identifikuar çështjet gjyqësore civile si një nga kërcënimet në rritje për lirinë e medias në Shtetet e Bashkuara.[5]

Shpesh të bazuara në dispozita ligjore të paqarta dhe të ndryshueshme, SLAPP përdorin disa strategji për të shteruar burimet dhe moralin në përgjithësi, që përfshijnë kërkesa të tepruara për dëmshpërblim dhe pretendime të dizajnuara për të shpifur, shqetësuar dhe mposhtur aktivistët dhe/ose organizatat e shoqërisë civile.

Nuk ka asnjë përkufizim të thjeshtë për ta shpjeguar këtë fenomen..

Megjithatë, në përgjithësi, këto padi përfshijnë elementët e mëposhtëm kritik:

ELEMENTE KRYESORE TË SLAPP

MASKIM
Maskim, si padi për shpifje apo shkelje të të drejtave kushtetuese dhe / apo civile. Pretendime për cenim imazhi dhe ofendim.

FRIKËSIM
Paditë nuk kanë për qëllim që të fitojnë drejtësi, por që të heshtin dhe frikësojnë gazetarin / aktivistin / organizatën.

PABARAZI
Këtu karakteristike është pabarazia e fuqisë dhe pasurisë mes paditësit dhe të padituri.

KËRKESA TË TEPRUARA
Kërkesa të larta dhe të palogjikshme për dëmshpërblim që ka për qëllim harxhimin e resurseve financiare dhe psikologjike të palës së paditur.

EFEKT ZMBRAPSJEJE (FTOHJEJE)
Efekt zmbrapsjeje dhe pengim në funksionimin normal të punës së personit të paditur.

5 *Ibid*

Prej këtu, sipas definicionit SLAPP janë: ***paditë për shpifje të ngritura për të parandaluar pjesëmarrjen aktive të publikut, duke përfshirë gazetarinë e interesit publik, protestat paqësore ose bojkotet, përfaqësimin, denoncimin, komentet akademike ose thjesht të folurit kundër abuzimit me pushtetin. SLAPP-et synojnë këdo që punon për të mbajtur përgjegjës të fuqishmit ose që merret me çështje me interes publik: të ashtuquajturit "mbrojtës publik". Kjo kategori e gjerë përfshin gazetarë, aktivistë, mbrojtës të të drejtave të njeriut, denoncues apo informatorë, organizata për fushatë, sindikata ose shoqata tregtare dhe akademikë[6].***

3.2 SLAPP nëpërmjet numrave – shembulli i Evropës

Sipas një studimi gjithëpërfshirës të CASE[7] të botuar në vitin 2023, në katër vitet e fundit ka pasur një rritje të madhe të rasteve SLAPP në të gjithë Evropën - me 539 raste në të gjithë Evropën, dhe një e pesta e këtij numri u regjistrua vetëm në vitin 2021. Një numër rekord i SLAPP-ve është regjistruar në vitin 2022, me 161 raste të regjistruara. Megjithatë, në realitet, numri është në fakt shumë më i lartë sepse zbulimi dhe identifikimi i rasteve të tilla ka rezultuar të jetë një sfidë vërtet e madhe.

Raste të regjistruara të SLAPP në periudhën 2010-2012 në Evropë



Sipas dokumentit të politikave, "SLAPPs në Evropë, si BE mund të mbrojë rojet nga paditë abuzive", Malta, Sllovenia, Kroacia dhe Irlanda kryesojnë listën. Malta kishte shkallën më të lartë të rasteve të SLAPP për kokë banori, me 3 padi në 100,000 njerëz, e ndjekur nga Sllovenia me 1.9 dhe Kroacia me 0.6. **Me 0.29 për 100,000 banorë, Maqedonia është në grupin e 10 vendeve me shkallën më të lartë të SLAPP sipas numrit të popullsisë.**

6 Coalition Against SLAPPs in Europe (CASE), SLAPPs: A TREATH TO DEMOCRACY CONTINUES TO GROW, A 2023 Report Updated, faqja 7

7 Koalicioni kundër SLAPP në Evropë (CASE), grup ombrellë që bashkon më shumë organizata mbrojtëse.

3.3 Cilat janë viktimat më të shpeshta të SLAPP?

Të dhënat e mbledhura kumulative tregojnë se gazetarët në kapacitetin e tyre individual mbeten objektivat më të mundshme të SLAPP-ve, të pasuar nga mediet, redaktorët, aktivistët dhe OJQ-të. Të paditur të tjerë të mundshëm përfshijnë avokatë, akademikë, politikanë, autorë librash (shkrimtarë) dhe botues. Në shumicën dërrmuese të rasteve, objektivi mbetet një individ kundrejt një organizate (paraqitja grafike më poshtë).

Viktima më të shpeshta



Individë vs organizata

3.4 Cilat janë bazat më të shpeshta për SLAPP?

Në vitin 2022, numri më i madh i padive strategjike për pjesëmarrjen e publikut në Evropë lidheshin me artikuj dhe informacione të botuara në lidhje me marrëveshjet e turbullta apo të dyshimta të biznesit (34%), të ndjekur nga korrupsioni (23%), Qeveria (10%) dhe mjedisi (8.3%).

Baza dhe arsye për padi të dorëzuara kundër pjesëmarrjes publike



3.5 Cili është paditësi dhe parashtruesi më i shpeshtë i SLAPP?

Gjatë vitit 2022, më së shumti padi kanë parashtruar biznesmenët dhe subjektet afariste (40%), pasuar nga subjektet shtetërore (26.8%) dhe politikanët (25%). Ky raport paraqet një tendencë shumëvjeçare. Siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm, ndërmjet vitit 2010 dhe fundit të vitit 2022, palët më të zakonshme në rastet e SLAPP ishin ata në pozitat e pushtetit; gjegjësisht biznesmenë dhe politikanë.

Kush është paditësi më i shpeshtë dhe parashtrues i padive SLAPP?

Subjekte shtetërore dhe politikanë
Një përqindje e lartë (mes 26 dhe 27%) të paditësve, janë politikanë apo organe/subjekte shtetërore

Biznesmenë
Biznesmenët dhe subjektet afariste kryesojnë në këtë kategori me 40% nga numri total i padive

4. RASTI I MALTËS DHE LINDJA E "LIGJIT TË DAFNES"

Në vitin 2017, në Maltë u vra gazetarja Daphne Caruana Galizia. Në kohën e vrasjes së saj, ajo po përballej me 48 padi strategjike kundër pjesëmarrjes në publik (SLAPP) nga politikanë, përfshirë ish-kryeministrin dhe ministrat e kabinetit. SLAPP-et janë pretendime që nuk lidhen kryesisht me kompensimin, por për të keqtrajtuar ose nënshtruar median dhe zërat e tjerë kritikë në shoqëri, dhe për të krijuar një efekt ftohës mbi të drejtën e lirisë së shprehjes.

Për më tepër, Daphne Caruana Galicia u përball me kërcënimin e një padie të tillë SLAPP nga një vend i tretë, nga Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara. Sipas hulumtimit të Koalicionit Kundër SLAPP-ve në Evropë (CASE), Caruana Galicia mbetet subjekti individual me numrin më të madh të rasteve SLAPP në Evropë. Për kritikët e saj, Caruana Galizia ishte një "blogere e urrejtjes" dhe një "shkrimtare e stilolapsave me helm" - "shtriga e Bidnias". Kritika helmuese ishte pjesërisht, rezultat i qasjes fisnore në sistemin politik dypartiak të Maltës.

Si rezultat i drejtpërdrejtë i advokimit të familjes së Daphne-së dhe shoqërisë civile, lëvizja anti-SLAPP është rritur më shumë për të adresuar problemin me SLAPP në Evropë. Në kujtim të trashëgimisë së Daphne Caruana Galicia, projekt-direktiva e propozuar nga Komisioni Evropian në prill të vitit 2022 njihet si "Ligji i Daphne-së". Ndërkohë, Këshilli i Evropës do të publikojë një raport gjithëpërfshirës me rekomandime anti-SLAPP në fillim të vitit 2024.

Prandaj, mund të thuhet me siguri se Malta është në fakt vendi nga e ka origjinën trajtimi me seriozitetin që ka në tokën evropiane kjo çështje, jo vetëm në aspektin e gazetarëve dhe organizatave të shoqërisë civil, por edhe në kontekstin më të gjerë në shoqëri, veçanërisht në shtetin e së drejtës.

5. LIGJE KUNDËR SLAPP

Rregulloret kundër SLAPP-eve synojnë të kufizojnë dhe/ose të pengojnë paditësit e mundshëm nga ngritja e padive shqetësuese që nuk kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave, por në fakt kanë për qëllim keqtrajtimin e të pandehurve. Rregullore të tilla zakonisht lejojnë rrëzimin e parakohshëm të kërkesave të tilla, dhënien e shpenzimeve të bëra nga i pandehuri dhe parashikojnë disa masa për të ndëshkuar abuzimin, si gjobë për paditësin.

Një sfidë në hartimin e legjislacionit anti-SLAPP është përcaktimi se si të synohen pretendimet abuzive pa mohuar të drejtat e atyre që ndjekin pretendime legjitime. Kjo është, në fakt, edhe pjesa më e vështirë e punës dhe sfida më e madhe.

Ligjet anti-SLAPP janë më të zhvilluara në SHBA, Kanada dhe Australi - ku ato dolën kryesisht nga konteksti i ligjit mjedisor - ndërsa në Evropë SLAPP-et mbeten kryesisht të papranuara, pa marrë shumë parasysh përdorimin dhe ndikimin e tyre. Sipas disa studiuesve, ky dallim bazohet në konsiderimin e ndryshëm të së drejtës së lirisë së shprehjes në sistemet kushtetuese të vendeve. Ndërsa liria e fjalës mbrohet si një e drejtë pothuajse absolute nga Amendamenti i Parë i SHBA-së, një ekuilibër i domosdoshëm midis kësaj të drejte themelore dhe interesave të tjera – siç janë të drejtat e imazhit – sigurohet në sistemet e brendshme dhe rajonale evropiane (p.sh. nga neni 10 (2) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

Që nga shkurti i vitit 2018, një grup deputetësh i kanë bërë thirrje Komisionit të BE-së të promovojë një direktivë të BE-së kundër SLAPP, e cila do t'u japë gazetarëve hulumtues dhe grupeve të medias fuqinë për të kërkuar anulimin e shpejtë të "padive shqetësuese" dhe për të krijuar një fond financiar për mbështetje të grupeve mediatike që ballafaqohen me padi të tilla. Përveç kësaj, eurodeputetët propozuan krijimin e një regjistri të ri të BE-së që do të "emëronte dhe turpëronte" kompanitë që praktikojnë SLAPP. Një nga arsyet që i shtyu euro-

deputetët të promovojnë një rregullore të tillë është pikërisht rasti i Daphne Caruana Galizia, e cila u vra në një makinë bombë tetorin e kaluar. Pas këtij rasti, prillin e kaluar, Malta dekriminalizoi shpifjen: megjithatë, amendamentet anti-SLAPP nuk u përfshinë.

5.1 Draft-direktivë e propozuar nga Komisioni Evropian

Më 27 prill 2022, Komisioni Evropian miratoi propozimin për një Direktivë për mbrojtjen e personave të përfshirë në pjesëmarrjen publike nga proceset ligjore qartazi të pabazuara ose abuzive ("Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike") dhe rekomandimin për mbrojtjen e gazetarëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut, që janë të përfshirë në pjesëmarrjen e publikut nga paditë qartazi të pabazuara ose abuzive ("Paditë Strategjike të Pjesëmarrjes Publike").[8]

Qëllimi i kësaj direktive është të eliminojë pengesat në lidhje me mbarëvajtjen e proceseve civile, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e personave fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në publik për çështje me interes publik, veçanërisht gazetarëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut, procedimeve kundër gjykatave, që ngrihen kundër tyre për t'i larguar ata nga pjesëmarrja publike (të quajtura zakonisht "padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike" ose "SLAPP").[9]

Sipas kësaj propozim-direktive, është e nevojshme të merret parasysh se pjesëmarrja e publikut nuk kryhet gjithmonë në mirëbesim. Përhapja e dezinformatave nuk duhet të mbrohet nga kjo direktivë. Për këtë qëllim, rregullat në këtë direktivë duhet t'i lënë diskrecionin gjykatës ose tribunalit në lidhje me çështjen, në mënyrë që të shqyrtojnë nëse zbatimi i masave mbrojtëse përkatëse është i përshtatshëm në një rast të veçantë. Për shembull, nëse pretendimet e bëra nga i pandehuri janë të sajuara dhe synojnë të dëmtojnë reputacionin e paditësit, të pandehurit nuk duhet t'i ofrohet mbrojtje.[10]

8 Council of the European Union, Proposal for a DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on protecting persons who engage in public participation from manifestly unfounded or abusive court proceedings ("Strategic lawsuits against public participation") https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52022PC0177

9 Ibid

10 Ibid

5.2 Draft-Rekomandim i Komitetit të Ministrave për luftimin e përdorimit të SLAPP

Këshilli i Evropës, duke parë domosdoshmërinë e mbrojtjes më të madhe të gazetarëve, ka hartuar një draft-rekomandim për të kundërshtuar përdorimin e SLAPP-ve ("Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike").

Këshilli i Evropës, në preambulën e këtij rekomandimi, i referohet, para së gjithash, detyrimit të shteteve anëtare për të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit, të garantuar nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj. Këshilli i Evropës i referohet gjithashtu detyrimit të tyre negativ për t'u përmbajtur nga ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe detyrimit pozitiv për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të favorshëm për të gjithë për të marrë pjesë pa frikë në debatin publik, edhe kur opinionet e tyre janë kundër atyre të autoriteteve zyrtare ose një pjese të konsiderueshme të publikut.

Përveç kësaj, në preambulë, Këshilli i Evropës jep një përkufizim të SLAPP, duke deklaruar se është një praktikë që synon të shkaktojë një efekt frikësues për lirinë e shprehjes, debatin publik dhe pjesëmarrjen publike nëpërmjet përdorimit abuziv ose keqdashës të procedurave ligjore për frikësimi strategjik, me qëllimin përfundimtar të heshtjes së kujtdo që dëshiron të marrë pjesë në debate publike ose çështje publike, duke përfshirë kërcënimin ose marrjen e masave ligjore për pretendime tërësisht ose pjesërisht të pabaza dhe shfrytëzimin e çekuilibrave në fuqinë financiare, politike ose shoqërore.

Në pjesën operative të rekomandimit, Këshilli i Evropës, në përputhje me nenin 15, përcakton dhe u rekomandon shteteve anëtare që të zbatojnë urgjentisht udhëzimet që jepen krahas këtij rekomandimi në përputhje me parimet e tij, për t'i kushtuar vëmendje të veçantë SLAPP gjatë rishikimit të legjislacionit, politikave dhe praktikës në përputhje me Direktivën për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias. Pjesa operative parashikon gjithashtu promovimin e qëllimeve të rekomandimit në nivel kombëtar dhe vendosjen e bashkëpunimit me të gjitha palët e interesuara për arritjen e këtyre synimeve, dhe kontrollin e rregullt të statusit të zbatimit të rekomandimit dhe informimin e Këshillit të Ministrave për masat e marra nga shtetet-anëtare dhe palët e tjera të interesuara, progresi i arritur dhe sfidat me të cilat përballen.

Në kuadër të projekt-rekomandimit, Këshilli i Evropës jep përcaktime të qarta të termave kyç për qëllimet e rekomandimit, duke filluar nga KEDNJ dhe praktika e vendosur e GJEDNJ. Në këtë seksion, Direktiva përcakton kryesisht pjesëmarrjen publike dhe interesin publik, të cilat si terma janë shumë specifikë dhe varen nga konteksti.

Pjesa thelbësore e rekomandimit janë treguesit që përcakton rekomandimi për identifikimin e qëllimit të fillimit të një çështjeje gjyqësore. Rekomandimi përcakton 8 tregues, të cilët nuk duhet domosdoshmërish t'i ketë një proces gjyqësor për t'u konsideruar si SLAPP.
Këto tregues përfshijnë:

(1) Synimi i paditësit për të përdorur një çekuilibër të pushtetit, siç është avantazhi i tij financiar ose ndikimi politik ose shoqëror, për të ushtruar presion mbi të pandehurin.

(2) Argumentet e formuluara në mënyrë agresive të paraqitura nga paditësi janë pjesërisht ose plotësisht të pabazuara.

(3) Nëse paditësi paraqet mjete juridike të cilat janë në disproporcion me të padituri.

(4) Nëse paditësi përdor taktika procedurale dhe gjyqësore, të tilla si zvarritja e procedurave, zgjedhja e një forumi në të cilin ligji ose aspekte të tjera të procedurës janë të favorshme për të, duke shkaktuar rritje të ngarkesës së punës, paraqitjen e ankesave me pak ose aspak perspektivë suksesi dhe duke shkaktuar kosto jo-proporcionale. ndaj të pandehurit.

(5) Procedurat ligjore drejtohen kundër individëve ose organizatave, ose individëve ose organizatave të lidhura me ta.

(6) Nëse procesi gjyqësor shoqërohet me një fushatë fyese në publik që synon të ngacmojë, diskreditojë ose frikësojë aktorët pjesëmarrës në debatin publik ose që synon të largojë vëmendjen nga çështja thelbësore në rastin konkret.

(7) Nëse paditësi ose përfaqësuesit e tij zbatojnë frikësim ligjo, ngacmim dhe kërcënim, ose kanë përvojë në kryerjen e veprimtarive të tilla.

(8) Paditësi ose palët e lidhura janë të përfshirë në procese ligjore të shumta dhe të koordinuara ose ndërkufitare të bazuara në të njëjtat fakte ose në lidhje me çështje të ngjashme.

Rekomandimi parashikon gjithashtu forma specifike të SLAPP-ve, duke njohur SLAPP-ët ndërkufitare dhe SLAPP-ët që synojnë pjesëmarrjen anonime të publikut..

Në fushën e mbrojtjes së SLAPP, rekomandimi parashikon në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë, masa mbrojtëse thelbësore, mjete juridike dhe transparencën në rastet e SLAPP. Përkatësisht, në fushën e mekanizmave mbrojtës, rekomandimi parasheh dy lloje: mekanizma mbrojtës ligjor dhe procedural. Mekanizmat ligjorë parashikojnë miratimin e legjislacionit që siguron që çdo person të mund të marrë pjesë në debate publike dhe në jetën

publike pa frikë dhe kërcënime, që do të jenë në përputhje me KEDNJ. Në fushën e mekanizmave procedurale, rekomandimi parashikon si vijon: menaxhim efektiv të çështjeve, hedhe poshtë në mënyrë të parakohshme të padisë kundër pjesëmarrjes publike, mos-ndryshim të kërkesëpadisë së padive SLAPP, procedura të shkurtuara në rast të padive SLAPP, kosto të procedurës dhe kompensimin e dëmit, kompensimin e shpenzimeve të procedurës gjyqësore në rastin e një SLAPP, pezullimin e procedurës gjyqësore në rast të vdekjes së të pandehurit.

Krahas mekanizmave mbrojtës, rekomandimi parasheh edhe mjetet e mëposhtme juridike në rastet e SLAPP: dhënien e shpenzimeve të procedurës, kompensimin e dëmeve ndaj viktimave të SLAPP, kufizimin e shumës së dëmit jo-material ndaj paditësit, masa për dekurajim për ngritjen e padive SLAPP. Sa i përket transparencës në rastet SLAPP, rekomandimi parasheh publikimin e konkluzave të gjykatës, kur bëhet fjalë për SLAPP, si dhe emrin e paditësit në përputhje me ligjet pozitive për mbrojtjen e standardeve personale dhe evropiane për liritë dhe të drejtat e njeriut. Krahas publikimit, rekomandimi parasheh edhe futjen dhe mirëmbajtjen e një regjistri publik të lëndëve gjyqësore dhe vendimeve që konsiderohen si SLAPP.

Së fundmi, rekomandimi ofron mënyra për të mbështetur në mënyrë gjithëpërfshirëse objektivat dhe viktimat e SLAPP, duke ofruar ndihmë ligjore, mbështetje financiare, mbështetje psikologjike, mbështetje praktike dhe mbështetje nga sektori privat.

Nga aspekti i parandalimit të përgjithshëm, rekomandimi thekson rëndësinë e programeve arsimore dhe programeve të trajnimit për profesionistët ligjorë dhe autoritetet publike, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së dhe standardeve dhe mekanizmave ndërkombëtarë, me theks në përfaqësimin gjinor. Nga ana tjetër, rekomandimi parashikon zhvillimin e strategjive dhe masave për ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për SLAPP-të dhe dëmet që mund të ndodhin në jetën publike dhe interesin publik prej tyre.

Ky dokument i Këshillit të Evropës është i një rëndësie të veçantë për njohjen dhe parandalimin e SLAPP-ve, si dhe mbështetje e fortë për luftën kundër rasteve ekzistuese SLAPP. Rëndësia e rekomandimit qëndron në qasjen e tij gjithëpërfshirëse, përmes së cilës, në fakt, ai kërkon të krijojë një sistem në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që do të garantojë parandalimin, identifikimin dhe luftën kundër të gjitha formave të ndalimit ose kufizimit të të folurit në publik, pjesëmarrjen në hapësirën publike dhe informimin për interesin publik në përputhje me standardet e përcaktuara nga GJEDNJ përmes mekanizmave të saj dhe praktikës së KEDNJ.

5.3 A nevojitet të bëhet një dallim mes mbrojtjes së gazetarëve dhe aktorëve të tjerë

Sinonim i pjesëmarrjes publike, respektivisht pjesëmarrja e publikut arrihet përmes gazetarëve. Ata janë gjithmonë në vijën e parë sepse kanë rolin e raportimit, transmetimit dhe komentimit të ngjarjeve dhe lajmeve, në radhë të parë në fushën e së drejtës publike dhe subjekteve publike, por edhe brenda subjekteve të së drejtës private. Megjithatë, edhe subjekte të tjera që nuk i përkasin ***per se*** tek mediat dhe gazetarët kanë pjesëmarrjen e tyre në debate, komente dhe kritika publike.

Ndoshta përgjigjen më të mirë për këtë pyetje e jep direktiva e propozuar e BE-së, e cila bën një lloj dallimi, jo aq të madh, por, megjithatë bën dallim mes gazetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në publik.

Sipas propozim-direktivës, gazetarët luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e debatit publik dhe në transmetimin dhe marrjen e informacionit, opinioneve dhe ideve. Ata duhet të jenë në gjendje të kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrë efektive, në mënyrë që të sigurojnë që qytetarët të kenë qasje në shumëllojshmërinë e pikëpamjeve në demokracitë evropiane. Është thelbësore që gazetarëve t'u lihet hapësira e nevojshme për të kontribuar në një debat të hapur, të lirë dhe të drejtë, për t'i rezistuar dezinformimit, manipulimit të informacionit dhe ndërhyrjes. Gazetarët duhet të jenë në gjendje të kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrë efektive për të siguruar që qytetarët të kenë qasje në pluralitetin e pikëpamjeve në demokracitë evropiane. Mbrojtja që u jepet gazetarëve, nën të drejtën e lirisë së shprehjes, si mirënjohje e rolit të tyre të rëndësishëm, i nënshtrohet dispozitës që ata duhet të veprojnë me mirëbesim, për të dhënë informacion të saktë dhe të besueshëm, në përputhje me etikën e gazetarisë.

Kjo direktivë nuk jep një definicion për një gazetar, pasi synohet mbrojtja e çdo personi fizik dhe juridik që angazhohet për pjesëmarrjen e publikut. Megjithatë, duhet theksuar se gazetaria është një funksion i ndarë mes një shumëllojshmërie të gjerë aktorësh, duke përfshirë reporterë, analistë, kolumnistë dhe blogerë, si dhe të tjerë të angazhuar në forma të vetë-botimit në shtyp, në internet ose hapësira të tjera.[11]

11 Ibid

6. SHQYRTIM I KORNIZËS RELEVANTE LIGJORE KUNDËR SLAPP NË RMV

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston një rregullore e veçantë kundër SLAPP. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se të pandehurit në procese të tilla mbeten pa asnjë mbrojtje, por se ata ushtrojnë të drejtat e tyre, gjegjësisht mbrojtjen brenda kushteve të përgjithshme të së drejtës pozitive, pa bërë dallimin se çfarë është padi SLAPP dhe çfarë nuk përfshihet në këtë kategori.

Këto lëndë të çfarëdo natyre qofshin ato, gravitojnë rreth disa ligjeve procedurale dhe materiale. Disa prej tyre janë lex generali, si Ligji për Procedurën Civile (LPC), Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), LSD ose janë lex specialis Ligji për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje (LPCFSH).

Megjithatë, për të shqyrtuar dispozitat e këtyre ligjeve, duhet të kemi parasysh kornizën kushtetuese.

6.1 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Sipas Kushtetutës, liria e shprehjes dhe mendimit është e garantuar.[12] Në vlerat themelore janë shënuar edhe

> *...liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit janë të pranuara me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutën*[13]

Kjo do të thotë se jo vetëm ato që jep dhe parashikon Kushtetuta jonë, por edhe ato të përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare, si supreme, njihen dhe pranohen nga Kushtetuta dhe nga rendi ynë juridik.

6.2 Ligje

6.2.1 Ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje

Ligji për Marrëdhëniet Detyruese, në thelb, rregullon parimet në bazë të të cilave ndodh dëmi, parimet në bazë të të cilave vërtetohet dhe përcaktohet përgjegjësia, gjegjësisht shpërblehet dëmi për fyerjen ose shpifjen.

12 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 16

13 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 8, Vlerat themelore

Ligji përfaqëson **lex specialis vis a vis** Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku përgjithësisht parashkruhen institutet e dëmit.

Meqenëse e drejta e lirisë së shprehjes është një e drejtë relative (që mund t'i nënshtrohet kufizimeve, por në raste të përcaktuara saktësisht), për të shmangur interpretimin arbitrar, janë përcaktuar përjashtime kur nuk ka përgjegjësi për fyerje, respektivisht shpifje. Pse është kjo e rëndësishme? Sepse ato paraqesin një lloj dige, pra një mekanizëm mbrojtës ndaj procedurës SLAPP, edhe pse kjo lloj padie nuk është veçuar në mënyrë specifike, përkatësisht e identifikuar në këtë ligj.

Për veprën fyerje, përjashtimet janë dhënë tek neni 7.[14]

Për shpifje, përjashtimet janë paraparë tek neni 10.[15]

6.2.1.1 Zhvendosja e barrës së dëshmisë

Gjëja imanente në rastet e shpifjes është se barra e provës, pra, mbi të gjitha, i takon të pandehurit. I pandehuri (gazetari, organizata civile, etj.), në fakt, duhet të provojë se pretendimi i bërë është i vërtetë, ose që ka pasur një arsye të vlefshme për të besuar në saktësinë e asaj që është bërë. Një barrë e tillë e kundërt e provës nuk do të thotë se nuk e favorizon të padituri në rastet SLAPP, sepse vetë mundësia e të padituri që të shtjellojë dhe vërtetojë më tej atë që është paraqitur është në dëm të paditësit. Prandaj, këto padi, pra mundësia e paraqitjes së tyre, kanë për qëllim arritjen e "efektit parandalues" që të padituri të mos paraqesin fare pretendime për të mos u ekspozuar ndaj të gjitha aspekteve negative të procedurës, si në një nivel personal dhe atë të biznesit. Kjo zhvendosje e barrës së provës do të thotë se i pandehuri ka për detyrë të dëshmojë se ajo që është paraqitur apo përcjellë ka qenë e vërtetë. Një barrë e tillë provash është një mekanizëm mbrojtës për paditësin, por edhe një ndihmë për gjykatën, sepse vërtet është e vështirë të vërtetohen faktet negative që do të paraqiteshin (p.sh. se nuk ka përvetësim, se nuk ka tradhti bashkëshortore, që fondet të mos keqpërdoren, etj.)

6.2.1.2 Mekanizma mbrojtëse në rastet e SLAPP

Mekanizmat mbrojtëse të parapara në rastet e SLAPP teorikisht mund të ndahen në 2 pjesë:

- Mekanizmat mbrojtës të natyrës procedurale
- Mekanizmat mbrojtës të natyrës materialo-juridike.

14 **Ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje** Numri i Gazetës Zyrtare të Maqedonisë së Veriut nr.251/2022 nga 22.11.2022, neni 7

15 **Ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje** Numri i Gazetës Zyrtare të Maqedonisë së Veriut nr.251/2022 nga 22.11.2022, neni 10

Sa i përket mekanizmave të natyrës materialo-juridike, situata është disi më e mirë. Si pjesa e fyerjes edhe ajo e shpifjes, e cila është veçanërisht interesante nga këndvështrimi SLAPP, kanë dispozita përjashtuese. Meqenëse rastet SLAPP përfshijnë më së shumti personazhe publike të politikës apo biznesit, të cilët prekin ose kanë lidhje me interesin publik, dispozita e nenit 7 paragrafi 3, 4 dhe 5 (që i referohet fyerjes)[16] dhe nenit 10 paragrafi 1 pika 4 (që i referohet shpifjes).[17]

Sido që të jetë, mekanizmi më i fortë mbrojtës i natyrës lëndore juridike, i cili mund të zbatohet për rastet SLAPP, është parimi i përgjithshëm i rregulluar në nenin 2 dhe nenin 3[18] të këtij ligji.

Kjo do të thotë se legjislacioni vendas nuk mund të jetë justifikim në vetvete kur bëhet fjalë për kufizimin e të drejtës së lirisë së shprehjes, prandaj si burim ligjor merren edhe mendimet juridike të shprehura në aktgjykimet e GJEDNJ-së, e cila është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin për gjykatat

6.2.2 Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD)

Parimet e LMD-së të dhëna në nenin 8 dhe 9 nënkuptojnë se e drejta për integritet personal, gjegjësisht afarist është një e drejtë absolute dhe çdokush ka për detyrë të sigurojë që të mos shkaktohet asnjë dëm për të drejtat personale të njohura, dhe për personat juridikë.[19]

LPCFSH i referohet LMD-së si rregullore me rastin e përcaktimit të kompensimit të dëmit. Nuk ka dispozita specifike që do të ishin të zbatueshme ekskluzivisht për rastet SLAPP, por në kuadër të dispozitave të përgjithshme për vlerësimin e dëmeve, mund të konstatohet se në përgjithësi tregohet kujdes për të siguruar që të mos ketë kërkesa të tepruara për dëmet që do të ishin arbitrare, dhe si të tilla, në vetvete janë një faktor për zmbrapsje për atë që synon të ngrejë një padi SLAPP kundër një gazetari të pandehur, organizatë qytetare, etj.

Veçanërisht interesante është dispozita nga neni 187-a, 188 dhe 189[20], ku parashikohet niveli dhe mënyra e kompensimit të dëmit jo-material, pra dallimi i bërë ndërmjet kënaqësisë morale dhe kënaqësisë materiale. Dhe kjo mundësi mund të jetë një faktor për zmbrapsje në vetvete.

16 **Ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje**, neni 10

17 **Ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje** Numri i Gazetës Zyrtare të Maqedonisë së Veriut nr.251/2022 nga 22.11.2022, neni 7 dhe neni 10

18 **Ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje** Numri i Gazetës Zyrtare të Maqedonisë së Veriut nr.251/2022 nga 22.11.2022, neni 2 dhe neni 3

19 **Ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje** Numri i Gazetës Zyrtare të Maqedonisë së Veriut nr.251/2022 nga 22.11.2022, neni 8 dhe neni 9

20 **Ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje** Numri i Gazetës Zyrtare të Maqedonisë së nr.251/2022 nga 22.11.2022, neni 187-a, neni 188 dhe neni 189.

6.2.3 Ligji për Sigurimin e Kërkesave

Kjo rregullore i përket fushës së legjislacionit procedural, por përmban edhe dispozita të së drejtës materiale. Me këtë rregullore, në fakt parashihet një pretendim i caktuar, pra në opinion njihet rëndom si caktimi i masave të përkohshme.[21] Meqenëse rastet SLAPP zakonisht kanë kërkesa të mëdha monetare në emër të dëmshpërblimit, kjo do të thotë se masat e tilla kërkojnë sigurimin e kërkesës monetare ndaj gazetarit, organizatës civile, para ose gjatë fillimit të procedurës.

Në praktikë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka pasur raste kur nga Gjykata është kërkuar të përcaktojë një masë të përkohshme që do të ndalonte botimin ose botimin publik e një libri dhe/ose artikulli, por nuk ka një qëndrim të njëtrajtshëm lidhur me pyetjen nëse dhe sa janë këto masa efektive.

Ajo që është më e rëndësishmja në lidhje me këtë rregullore është se lista e masave të përkohshme që parashikon ligji nuk është përfundimtare, por udhëzuese, sepse në të përdoret termi "mund të lejohet çdo masë që arrin qëllimin e këtij sigurimi, dhe në veçanti.[22]

6.2.4 Ligji për procedurë civile

LPC është një ligj procedural, i cili rregullon vetë procedurën në të cilën zhvillohen këto padi. Ky ligj nuk ka dispozita të veçanta që do të ishin drejtpërdrejt të zbatueshme për padi të këtij llloji, por mund të zbatohen **mutatis mutandis**. Kur themi të aplikohen, nënkuptojmë se ekziston një mekanizëm me të cilin ato padi, nëse identifikohen, do t'i nënshtrohen një shqyrtimi më të rreptë.

Në thelb, gjykata nuk ka shumë hapësirë manovrimi për të ndërhyrë me zgjidhjen aktuale ligjore. Asaj i lihet mundësia e gjykimit, e cila vjen në përfundim të vetë procedurës. Megjithatë, disa dispozita, nëse përpunohen, ose interpretohen më gjerësisht, mund të gjejnë zbatim në fazën që i paraprin aktgjykimit.

Interesant është instituti padi për dëshmi, ku parashikohet që të dëshmohet interesi juridik për zhvillimin e një kontesti të tillë. Paditë SLAPP zakonisht kanë kërkesë, jo vetëm për gjykim deklarues, por gjithashtu përmbajnë një kërkesë dënimi, e cila kërkon një veprim ose kufizim ose zmbrapsje të caktuar. Megjithatë, ekziston mundësia për të kërkuar vërtetimin e interesit ligjor nga ana e paditësit, ajo ekziston, qoftë edhe në këtë shtrirje më të ngushtë. Sigurisht që nuk përjashtohet mundësia e ndërhyrjes legjislative në këtë drejtim në të ardhmen.

Në thelb, e vetmja mundësi ku gjykata mund të ndërhyjë teorikisht të paktën dhe potencialisht është faza e shqyrtimit paraprak të padisë, si dhe faza e seancës përgatitore.

21 Ibid

22 Ibid

6.3 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në luftën kundër SLAPP

KEDNJ është pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe nuk mund të shmanget me ligj. Akoma më interesant është fakti se pikëpamjet e saj, gjegjësisht pikëpamjet e gjykatës të shprehura në aktgjykime, zbatohen drejtpërdrejt në rendin juridik të brendshëm. Neni 10, sigurisht nga pikëpamja e Konventës, është i rëndësishëm për çështjen e SLAPP.[23]

6.3.1 Përjashtimet nga liria e shprehjes sipas KEDNJ

Ekzistojnë 2 teste të përdorura për të shqyrtuar kufizimet e mundshme të lirisë së shprehjes sipas nenit 10, përkatësisht nëse kufizime të tilla janë:

1) të përcaktuara me ligj

2) kanë një qëllim legjitim

3) janë të nevojshme në një shoqëri demokratike

(a) "të përcaktuara me ligj"

Ndërhyrja në lirinë e shprehjes shkelë Konventën nëse ajo nuk plotëson kriteret e përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 10. Prandaj duhet të përcaktohet nëse ajo është "e parashikuar me ligj". Autoritetet kombëtare, dhe veçanërisht gjykatat, duhet të interpretojnë ligjin e brendshëm. Përveç nëse interpretimi është arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, roli i gjykatës është i kufizuar në përcaktimin nëse efektet e atij interpretimi janë në përputhje me Konventën (Cangi kundër Turqisë, § 42).

A ishte ndërhyrja për një "qëllim legjitim", respektivisht a ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike"

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, gjykata disa herë ka nënvizuar se lista e qëllimeve legjitime të dhëna në paragrafin 2 të nenit 10 është shteruese. I interpretuar në mënyrë rigoroze, ky pozicion – përjashtimisht, duke pasur parasysh rolin e tij të veçantë në shoqëri – i jep mbrojtje vetëm një dege të autoritetit publik, gjyqësorit.[24]

Gjykata ka konsideruar prej kohësh se e drejta për mbrojtjen e imazhit është një e drejtë që mbrohet nga neni 8 i Konventës, si pjesë e së drejtës për respektimin e jetës private. Koncepti i "jetës private" është një term i gjerë, që nuk i nënshtrohet përkufizimit shterues, i cili përfshin si

23 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 10

24 Morice v. France [GC], бр. 29369 /10, §§ 128-30, GJEDNJ 2015).

integritetin fizik ashtu edhe atë psikologjik të një personi. Megjithatë, që neni 8 të hyjë në fuqi, sulmi ndaj reputacionit të një personi duhet të arrijë një nivel të caktuar serioziteti dhe në një mënyrë që shkakton shkelje të gëzimit personal të së drejtës për respektimin e jetës private (shih, me referenca të mëtejshme, Medžlis Islamske zajednice Brčko dhe të tjerët kundër Bosnje dhe Hercegovinës [GC], Nr. 17224/11, § 76, 27 qershor 2017).

c) janë të nevojshme në një shoqëri demokratike

Parimet e përgjithshme për vlerësimin e domosdoshmërisë së ndërhyrjes në lirinë e shprehjes, të përsëritura shumë herë nga Gjykata që nga vendimi i saj në Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, u përmblodhën në Stoll kundër Zvicrës [GC] (§ 101) dhe u ritheksuan në Morice v. Franca [GC] (§ 124) dhe Pentikäinen kundër Finlandës [GC] (§ 87).

Prandaj, Gjykata në jurisprudencën e saj ka zhvilluar konceptin autonom nëse ndërhyrja është "proporcionale me qëllimin legjitim", i cili përcaktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, duke përdorur kriteret e përcaktuara në jurisprudencën e gjykatës dhe me ndihmën e parimeve dhe mjeteve të ndryshme interpretuese.

6.3.2 Fragmente nga jurisprudenca e GJEDNJ-së relevante për SLAPP

Sa i përket çështjeve në Evropë, ekzistojnë parime të ndryshme të praktikës gjyqësore që mund të jenë bazë ligjore për rregulloret anti-SLAPP, duke filluar me rastin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) Handyside v. UK (1976), i cili thotë se një shoqëri demokratike duhet të tolerojë gjithashtu ato ide "të cilat ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose cilëndo pjesë të popullsisë".

Një tjetër rast kyç është Steele Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar (2005), ku GJEDNJ konstatoi shkelje të Art. 10 të Konventës: përkatësisht dy anëtarëve të London Greenpeace, iu kërkua dëmshpërblim prej 40.000 eurosh për dëmtimin e reputacionit të kompanisë "McDonald's" përmes një pamfleti të titulluar "Çfarë nuk shkon me "McDonald's"?". Sipas gjykatës, shkelja rrjedh nga pamundësia e shtetit për të garantuar ndihmën juridike për aktivistët – të cilët ishin individë me të ardhura shumë të ulëta kundër një prej kompanive më të pasura në botë – dhe shumës së shpërblimit ndaj tyre.

Megjithatë, GJEDNJ-ja iu referua SLAPP-ëve për herë të parë në vitin 2022, në çështjen OOO Memo kundër Rusisë.

OOO Memo v. Russia

Çështja ka të bëjë me një padi civile për shpifje të ngritur nga një organ shtetëror rajonal rus kundër një kompanie mediatike. Kompania mediatike u urdhërua të publikonte një tërheqje në faqen e saj të internetit ku do të theksonte se kishte publikuar deklarata të rreme, duke dëmtuar kështu reputacionin e biznesit të paditësit. GJEDNJ konstatoi se, ndërsa procedurat civile të shpifjes ishin të hapura për kompanitë private ose publike për të mbrojtur reputacionin e tyre, ky nuk mund të ishte rasti për një organ ekzekutiv të madh të financuar nga taksapaguesit siç është paditësi në këtë rast. Gjykata vendosi se ndërhyrja në të drejtën e kompanisë mediatike për lirinë e shprehjes, siç garantohet me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nuk justifikohej nga një "qëllim legjitim", sepse shteti rajonal rus nuk mund të mbështetej në "mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve", siç thuhet në nenin 10 § 2 të KEDNJ.

Për më tepër, GJEDNJ-ja konstatoi se lejimi i organeve ekzekutive për të ngritur procedime për shpifje kundër anëtarëve të medias, vendos një barrë të tepruar dhe jo-proporcionale për median dhe mund të ketë një efekt të pashmangshëm ftohës mbi median në kryerjen e detyrës së tyre për të ofruar informacion dhe monitorim të publikut.

Vendimi në çështjen OOO Memo kundër Rusisë është një sinjal i ri alarmi se SLAPP, si një formë e procesit gjyqësor abuziv, kërcënon të drejtën e lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike, siç është theksuar së fundi në dokumentet e politikave, planet e veprimit dhe rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian, dhe siç dokumentohet në raportet vjetore të platformës së Këshillit të Evropës për promovimin e mbrojtjes së gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve. SLAPP-të ndodhin në lloje të ndryshme veprimesh ligjore, ku shpifja është zgjedhja kryesore e paditësve, e ndjekur nga pretendimet e paraqitura sipas ligjeve të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave. Një nga institucionet e para evropiane që theksoi fenomenin shqetësues të SLAPP-ve në Evropë ishte Komisionerja për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës. Në komentin e saj për të drejtat e njeriut të 27 tetorit 2020, "Është koha për të ndërmarrë veprime kundër SLAPP-ve", Komisionerja Dunja Mijatović bëri thirrje që të ndërmerren urgjentisht veprime efektive kundër SLAPP-ve.

Gelevski kundër Maqedonisë së Veriut[25]

Në shtator të vitit 2020, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut nxori një aktgjykim me të cilin sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, u konstatua se liria e shprehjes së z. Gelevski ishte shkelur, dhe urdhëroi Republikën e Maqedonisë së Veriut t'i

25 RASTI GELEVSKI kundër MAQEDONISË SË VERIUT] (Aplikimi nr. 28032/12), Aktgjykimi, 08.10.2022 https://hudoc.echr.coe.int/fre/#{%22itemid%22:[%22001-204818%22]}

paguajë atij kompensim në shumën prej 3000 eurosh për shkak të shkeljes së të drejtës së lirisë së shprehjes.

Ky aktgjykim lidhet dhe i referohet rastit në të cilin kryeredaktori i atëhershëm i televizionit Sitel dhe kryeredaktor i gazetës "Veçer" – Pavloviq, ka iniciuar padi kundër Nikolla Gelevskit për shkak të tekstit të tij "Megafonë nga Rruga e Fuhrerit", botuar më 31 mars 2009 në "Utrinski Vesnik". Pavloviç kishte vlerësuar se Gelevski i lëndoi ndjenjat e tij. Gjyqi zgjati rreth një vit dhe Pavloviq para gjykatave maqedonase fitoi padinë private për fyerje dhe shpifje kundër ish-kolumnistit të "Utrinski Vesnik", Nikolla Gelevski.

Pasi që aktgjykimi kundër Gelevskit u konfirmua nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, Gelevski parashtroi ankesë në Gjykatën për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, e cila vendosi në favor të tij. Në shpjegimin e aktgjykimit thuhet se **"Qeveria ka pranuar se ka pasur ndërhyrje në lirinë e shprehjes së ankuesit". "Gjykata vëren se ankuesi ishte një kolumnist i rregullt në gazetën e përditshme. Prandaj ndërhyrja duhet të shqyrtohet në kontekstin e rolit thelbësor të lirisë së medias në sigurimin e funksionimit të duhur të shoqërisë demokratike".**

Gjithashtu, në lidhje me gjuhën e përdorur nga Gelevski, gjykata përsërit se **"individëve, dhe veçanërisht gazetarëve që marrin pjesë në një debat publik për një çështje me interes të përgjithshëm, u lejohet të aplikojnë një shkallë të caktuar ekzagjerimi ose provokimi". Në fund, gjykata mendon se "aktgjykimi penal i shqiptuar ndaj Gelevskit pa dyshim mund të ketë një efekt frikësues ndaj mediumeve në debatin politik për çështje të rëndësishme".**

● *Makraduli kundër Republikës së Maqedonisë*

Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i shqiptuar në këtë rast rezulton nga dy aplikime të veçanta të paraqitura nga i njëjti ankues, z. Jani Makraduli, i cili në kohën e zhvillimit të procedurës brenda gjykatave të vendit, ishte nënkryetar i partisë opozitare LSDM dhe deputet në Kuvendin e Maqedonisë. Gjykata këtu merret me themelin e pretendimeve të tij se dënimet penale për shpifje çuan në shkeljen e lirisë së tij të shprehjes, e garantuar nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Prandaj, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka nxjerrë dy aktgjykime për shpifje ndaj politikanëve në Republikën e Maqedonisë, të cilat janë kufizime të pajustifikuara të së drejtës së lirisë së shprehjes. Politikani i opozitës maqedonase ishte akuzuar për shpifje, pasi në konferencën zyrtare për shtyp të partisë politike ka dhënë deklarata kritike ndaj kreut të Agjencisë për Siguri dhe Kundërzbulim. Ai iu drejtua gjykatës së Strasburgut pasi gjykatat vendase konfirmuan vendimet e tij, duke këmbëngulur se vendimet janë një baraspeshë midis të drejtave për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjes së

imazhit. Gjykata thekson se fjalimi politik gëzon mbrojtje veçanërisht të fortë sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe se, megjithëse politikanët kanë të drejtë të mbrojnë reputacionin e tyre, "politikani në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije hapet ndaj një shqyrtimi të mbyllur të çdo fjalimi dhe vepre të tij, edhe nga gazetarët edhe nga publiku në tërësi, dhe duhet të tregojë një shkallë më të madhe tolerance" (paragrafi 71).

Gjatë përcaktimit të shkeljeve të nenit 10, gjykata trajtoi gjithashtu çështjen e natyrës dhe ashpërsisë së sanksioneve të vendosura, duke theksuar se edhe natyra relativisht modeste e gjobave, në vetvete, nuk e mohon rrezikun e një "efekti parandalues" në ushtrimin e ardhshëm të lirisë së shprehjes. Gjykata vlerësoi se edhe pse gjoba e vendosur nuk mund të arkëtohej më, për shkak të ndryshimeve ligjore që dekriminalizuan shpifjen, dënimi i ankuesit pati një efekt ftohës (chilling effect) në debatin politik që ai filloi për çështjet me interes të përgjithshëm. Në përgjithësi, gjykata arriti në përfundimin se standardet e aplikuara në procedurat e kontestuara ishin të papajtueshme me parimet e mishëruara në nenin 10 të Konventës dhe gjykatat vendase nuk arritën të gjejnë një ekuilibër të drejtë midis interesave konfliktuale që prekeshin. Për rrjedhojë, ndërhyrja ishte në disproporcion me qëllimin dhe nuk ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike", në kuptimin e nenit 10 paragrafi 2.

6.3.3 Shembuj të SLAPP në botë dhe rajon

Praktikat e SLAPP po rriten në mbarë botën dhe nuk kufizohen tashmë vetëm me padi civile. Në vend të kësaj, mund të ngrihen disa pretendime kriminale strategjike, me synimin për të heshtur zërat e padëshiruar. Në Itali, për shembull, akuzat për shpifje përdoren shpesh kundër gazetarëve kritikë, veçanërisht ata që trajtojnë storje për personazhe publike ose biznesmenë të njohur. Nëse gazetari nuk është në gjendje të mbrohet kundër rasteve të tilla, mund të rezultojë në sanksione penale ose urdhra për të kompensuar ata që pretendohet se janë dëmtuar nga deklarata e diskutueshme. Ky është rasti, për shembull, me gazetaren hulumtuese Amalija de Simon, e cila në vitet e fundit ka pësuar disa padi ofenduese(kryesisht raste shpifjesh penale) nga biznesmenë të pasur, si dhe nga zyrtarë publikë, pasi raportoi për gjoja aktivitetet e tyre të paligjshme. Të akuzuarit, të cilët ende nuk janë në proces, janë refuzuar nga prokurori publik para se të arrijnë në gjykatën e shkallës së parë.

Ashtu si me rastin DeSimone, SLAPP-të shpesh nuk rezultojnë në një vendim përfundimtar kundër të pandehurit. Paditësit e dinë që në fillim se akuzat e tyre janë të pabaza ose të ekzagjeruar. Megjithatë, ata gjithashtu e dinë se padia dhe përballja me hetimet dhe gjykimin e mundshëm është e shtrenjtë dhe kërkon kohë. Rrjedhimisht, paditë për ngacmim mund të

kenë efekte të mëdha ftohëse, duke penguar një gazetar, operator ose folës të padëshiruar të ushtrojë të drejtën e tij për të kritikuar ose raportuar.

Disa shembuj eklatant të SLAPP-eve nga SHBA janë dy rastet në vazhdim:

● Çështja e SLAPP dhe Sacha Baron Cohen

Në vitin 2006, një grua ngriti një padi kundër Sacha Baron Cohen, rrjetit televiziv Channel 4 dhe emisionit të HBO "The Ali G", duke pretenduar se Cohen, ndërsa luante rolin e "Ali G", e kishte përmendur atë me emër dhe e kishte shpifur gjatë intervistës së rreme me historianin Gore Vidal.

Në dhënien e vendimit në vitin 2009, gjykata u shpreh se *"asnjë person i arsyeshëm nuk mund t'i konsideronte fakte dhe të vërteta deklaratat e bëra nga "Ali G"* në program "dhe për këtë arsye ata nuk plotësonin veprën dhe kualifikimin e shpifjes.

● Rasti i fermerëve të Teksasit kundër Oprah Winfrey

Në ndoshta SLAPP-in më të famshëm, Oprah Winfrey u padit nga fermerët e Teksasit në 1996 pas një show të quajtur "Ushqim i rrezikshëm" në të cilin ajo ftoi ekspertë të lopëve të çmendura dhe deklaroi se nuk do të hante më kurrë hamburger.

Fermerët ngritën një padi duke kërkuar më shumë se 12 milionë dollarë dëmshpërblim. Teksasi nuk ka ligj anti-SLAPP, kështu që Winfrey luftoi SLAPP-et për gjashtë javë për-para se një juri të vendoste në favor të saj. Në apel në vitin 2000, qarku i pestë i SHBA-së konfirmoi vendimin.

Rasti SLAPP që vjen nga fqinjët është interesant. Rrjeti serb i raportimit të krimit dhe korrupsionit "Krik" është gjobitur për publikimin e lajmeve për një gjyq të bandës krim-inale në Serbi.

"Krik" citoi materiale gjyqësore nga një gjyq publik kundër një bande kriminale lokale të quajtur Grupi Jotka në prill të vitit 2021. Media citoi të pandehurit të thoshin se grupi kishte lidhje me ministrin e brendshëm, i cili është gjithashtu një anëtar i lartë i Partisë Progresive Serbe dhe një ish-kryetar i Agjencisë së Informacionit të Sigurisë së Serbisë (BIA). Një bisedë e përgjuar, për të cilën i pandehuri pretendon se mund të jetë zemra, është baza e kësaj padie. Një fakt alarmues është edhe ai se bashkëshorti i gjykatëses që dënoi "Krikun" është shok i ngushtë i një ministri tjetër serb nga Partia Përparimtare. Padia është një nga 12 paditë SLAPP që synuan "Krik" që nga viti i kaluar dhe ka qenë subjekt i një reagimi të ashpër nga media dhe organizata të shumta.

6.4 Lëndë SLAPP në gjykatat kombëtare

Në gjykatat kombëtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nuk është e mundur lehtësisht të bëhet identifikimi i qartë i rasteve të SLAPP, për faktin se gjatë periudhës në të cilën ato janë zhvilluar nuk janë përditësuar treguesit për të përcaktuar një SLAPP. Në lëndët që janë zhvilluar dhe janë duke u zhvilluar para gjykatave në RMV, ka përfaqësim të SLAPP në të gjitha procedurat gjyqësore, gjegjësisht në ato civile dhe penale para.

Në SLAPP-et e mundshme, përveç procedurave civile në periudhën 2008-2016, edhe pas kësaj periudhe ka pasur raste që janë iniciuar nga prokuroria publike, përkatësisht autoritetet hetuese dhe gjyqësore, ndërsa gjykatat janë keqpërdorur nga pushteti ekzekutiv për të kufizuar lirinë e fjalës dhe pjesëmarrjen në hapësirën publike.

Rasti i parë karakteristik i krimit të organizuar është i ashtuquajturi Rasti "Pajazhina", në të cilin objekt hetimi ishin televizioni A1 dhe kompani të tjera të familjes Ramkovski. Përkatësisht, në periudhën para hapjes së hetimeve kundër biznesmenit Velia Ramkovski, ai ishte kritik i ashpër i pushtetit për shkak të sundimit të saj autokratik dhe korruptiv. Ky rast u karakterizua nga intensiteti dhe shtrirja e mekanizmave që u zbatuan dhe u përdorën, si nga Drejtoria e Të Ardhurave Publike, ashtu edhe nga institucionet e tjera financiare, të cilat kanë kompetenca hetimore. Ky rast përfundoi me dënime për pronarin e televizionit A1, si dhe për familjarët dhe bashkëpunëtorët e tij, por efekti përfundimtar i këtij rasti ishte mbyllja e televizionit A1, i cili ishte më i zëshmi kundër Qeverisë që ishte krijuesi i të ashtuquajturit shtet i kapur gjë që u konstatua nga grupi i ekspertëve të Reinhard Priebe. Pikërisht në Raportin e Priebe-s është bërë rekomandimi i mëposhtëm, i cili mund të thuhet se vlen për SLAPP. "Veprimet e shpifjes nuk duhet të përdoren si një mjet për të mbyllur debatin ose për të parandaluar që figurat publike të mbahen përgjegjës. Ekziston një shqetësim i veçantë kur politikanët padisin gazetarët për shpifje, por edhe kur padisin figura të tjera politike, në vend që të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre me mjete të tjera si debati publik".

Rasti i dytë, po ashtu karakteristik penal, ishte rasti "Likuidimi", në të cilin ndër tetë të tjerët ishte dënuar edhe gazetari Tomisllav Kezharovski, fillimisht me 4,5 vjet, e më pas dënimi i tij ishte ulur në 2 vjet burgim efektiv. Gazetari Tomisllav Kezharovski u dënua pasi në vitin 2008 në revistën "Reporter 92" gjoja kishte zbuluar identitetin e dëshmitarit të mbrojtur në këtë rast gjyqësor. Gazetari Kezharovski u përfshi në rastin "Likuidimi" menjëherë pas informacioneve për hulumtimin e tij për aksidentin e trafikut në të cilin humbi jetën pronari i të përjavshmes "Focus", Nikolla Mlladenov, një nga kritikët më të shquar të pushtetit në atë kohë. Në fund procedura u ndërpre për shkak të vjetërsimit.

Rasti i tretë penal nuk kishte të bënte me SLAPP ndaj gazetarëve dhe mediave, por kishte cak fermerin Dushko Ilievski, person i cili doli publikisht si udhëheqës i protestave kundër

qumështores “Svedmilk”, investim i huaj i mbështetur nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Ilievski u arrestua sepse dyshohej se kultivon marihuanë së bashku me vëllain e tij. Pas më shumë se dhjetë ditëve paraburgim, Ilievski dhe vëllai i tij u liruan sepse bëhej fjalë për konop të egër, që ka mbirë vetë, jo për marihuanë të kultivuar. Pas disa vitesh, Ilievski u akuzua për sulm ndaj një zyrtari gjatë të ashtuquajturës “Revolucioni laraman” nga e njëjta përbërje qeveritare për shkak të rolit të tij aktiv edhe në këto protesta.

Këto ishin tri çështje të veçanta gjyqësore, të cilat ishin objekt i procedimit penal, përmes të cilave elita politike, në fakt, përdori SLAPP-et për t’i hequr ato fillimisht dhe nëse kjo nuk ishte e mundur, për t’i kufizuar që të vepronin në hapësirën publike.

Në sferën e procedurës civile ka një praktikë gjyqësore të zhvilluar për faktin se në vitin 2012 me miratimin e Ligjit për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje këto vepra u dekriminalizua. Në këtë analizë dëshirojmë të shqyrtojmë disa nga gjykimet që mund të kenë elemente SLAPP, të cilat janë vënë në dukje nga avokatët e intervistuar.

1. Ali Ahmeti kundër ATV Media Company Sh.PK Shkup dhe Isen Saliu

Paditësi Ali Ahmeti ka kërkuar të vërtetohet se kompania ATV Media DOOEL Shkup dhe Isen Saliu janë përgjegjës për shpifje ndaj tij për faktin se të paditurit kanë lejuar publikimin e fakteve të pavërteta, të dëmshme për nderin dhe imazhin e tij, përmes faqes së internetit të gazetës së përditshme “Lajm”, ku është shkruar se “Ali Ahmeti ka kërcënuar personin Rafiz Aliti se do ta përjashtojë nga partia Bashkimi Demokratik për Integrim.” Njëkohësisht, paditësi Ahmeti ka kërkuar nga Kompania ATV Media DOOEL Shkup që t’i paguajë dëm jomaterial në shumë prej 15.000 eurosh, ndërsa personi Isen Saliu në shumë prej 10.000 eurosh, si dhe të pandehurit të obligohen me shpenzimet e veta që aktgjykimin ta publikojnë në lajmet kryesore në tre televizione kombëtare dhe në portalin më të lexuar të internetit në Republikën e Maqedonisë. Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup ka sjellë Aktgjykim P5-17/18, me të cilin e ka refuzuar padinë si të pabazë sepse nuk ka konstatuar elemente të shpifjes. Ky aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit në Shkup me Aktgjykimin GŽ-57/19 të datës 13.2.2019.

2. E Majta kundër Xhabir Derallës

Partia politike E Majta si paditëse ka ngritur padi për shpifje kundër gazetarit Xhabir Deralla për dy tekste të publikuara në rubrikën “Rafall” në ueb faqen www.civilmedia.mk, të cilat janë ribotuar në “Sllobodën Peçat” dhe në portalin Plusinfo, me pretendime se i pandehuri ka deklaruar gënjeshtra në to: “Dëshmuan se punojnë për Kremlinin. Apasievi, shoku i “Gebelsit të Velesit” , siç e quajnë në vendin e tij të lindjes “skakuta” përreth me mjekrën e tij e shpërndan renë Vmro-Moskovike. Por kjo nuk e pengoi atë të merrte donacione nga donatorë perëndimorë, si ai i fondacionit “Rosa Luxemburg” për fonde të të majtëve në Dojran. Një pjesë e strategjisë së instalimeve shkatërruese anti-perëndimore është të bëjnë pikërisht këtë

- të ngrenë dhe financojnë sa më shumë vatra dhe qeli të jetë e mundur"... E djathta/e majta e prishi komoditetin e saj të pasdite së të dielës dhe nuk e lanë veten të dëshpërohen shumë për dështimin e fushatës së tyre ruse. Ndonëse veprimet e këtyre gjoja të majtëve janë lexuar prej kohësh,dhe janë qesharake dhe groteske, "Njoftimi" i tyre është një sinjal se as ambasada ruse në Shkup dhe as familja (të paktën një pjesë e saj) nuk po heqin dorë nga beteja për destabilizimin dhe mbajtjen e Maqedonisë në të kaluarën." , paditësi E Majta nuk ka kërkuar kompensim për dëmin për shkak të dëmtimit të nderit dhe imazhit. Gjykata themelore civile në Shkup ka sjellë aktgjykimin P5-4/19, me të cilin padinë e ka refuzuar si të pabazë në tërësi. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Civile me Aktgjykimin GZH-819/20 është vërtetuar nga Gjykata e Apelit Shkup.

3. Milenko Nedellkovski kundër Mlladen Çadikovskit, Vlladimir Tevçevit dhe Dobrivoj Budimskit

Në këtë rast, paditësi është gazetari Milenko Nedellkovski, i cili ka ngritur padi kundër gazetarëve Mlladen Çadikovski, Vlladimir Tevçev dhe Dobrivoj Budimski për shpifje, për shkak të publikimit të përmbajtjes se "Milenko Nedellkovski ka rroga borxh" të publikuar në televizionin A1. Me padinë, paditësi Nedelkovski ka kërkuar edhe kompensim për dëmin jo-material nga Mlladen Çadikovski, si kryeredaktor dhe përgjegjës në shumë prej 400.000 denarësh, nga i padituri i dytë gazetari Vlladimir Tevçev ka kërkuar 100.000 denarë, dhe nga Dobrivoj Budimski 100.000 denarë. Gjykata Themelore Civile e Shkupit ka sjellë aktgjykimin P4-a-122/13, me të cilin padinë e paditësit e ka refuzuar si të pabazë në tërësi. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Civile është vërtetuar me GŽ-822/16 nga Gjykata e Apelit në Shkup.

Nëse merren parasysh rastet e përmendura, shihet qartë se liderët apo subjektet politike synojnë të ndikojnë në diskursin e raportimit dhe informimit të gazetarëve duke nisur çështje gjyqësore ndaj disa prej tyre. Në rastet konkrete është interesant fakti se në pjesën e kompensimit të dëmit dallojnë në mënyrë drastike, sepse në një çështje gjyqësore nuk kërkohet fare kompensimi i dëmit jo-material, ndërsa në dy të tjerat kërkohet në mënyrë të qartë. Është interesant fakti se gazetari Milenko Nedellkovski vetëm ka kërkuar kompensim për dëmin, por jo edhe falje publike për publikimin e të pavërtetave, me të cilat dëmtohet imazhi i tij personal, por gjykata e shkallës së parë dhe e dytë kanë konstatuar se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për shpifje.

7. INTERVISTA ME PALË RELEVANTE

Në kuadër të analizës, autorët kanë kryer intervista me palët të cilat më së shpeshti janë të përfshirë në procese gjyqësore, për të cilat ekziston rreziku që të futen nën SLAPP, gjegjësisht me avokatët që më së shpeshti janë të përfshirë në përfaqësimin dhe mbrojtjen e gazetarëve , gjykatësit që veprojnë në padi dhe akuza kundër gazetarëve, si dhe vetë gazetarët të cilët më së shpeshti janë të paditur, pra të akuzuar për shkak të punës së tyre.

Duke u nisur nga fakti se vetë SLAPP mund të zhvillohet në disa procedura, ju afruam gjykatësve që zhvillojnë procedura penale dhe civile, në të cilat gazetarët mund të paraqiten si të paditur apo të akuzuar. Andaj, në kuadër të intervistave të planifikuara janë mbajtur intervista me një gjykatës nga Gjykata Themelore Penale - Shkup dhe një gjykatës nga Gjykata Themelore Civile në Shkup, si gjykata në të cilat janë zhvilluar ose janë duke u zhvilluar numri më i madh i lëndëve gjyqësore kundër gazetarëve dhe ata marrin pjesë në lëndët e këtij lloji.

Në fillim të intervistave, gjykatësit theksuan rolin e gazetarëve si mbrojtës të interesit publik, por edhe cenueshmërinë e tyre për shkak të ekspozimit të tepruar ndaj sulmeve nga grupet e interesit që kanë pushtet në segmente të ndryshme të shoqërisë, si në atë politike, ekonomike, financiare, të sigurisë dhe të tjera segmente.

Në pjesën e procedimit penal, një gjykatës i Gjykatës Penale theksoi dekriminalizimin e shpifjes dhe fyerjes, por tha se presioni nuk është zhdukur plotësisht. Respektivisht, ekzistojnë dy lloje të presionit, ndikimi për të kufizuar apo penguar pjesëmarrjen e gazetarëve në hapësirën publike. Presioni në formë SLAPP, në procedurën penale, ndodh në kuadër të akuzave për vepra të ndryshme penale të llojit të zbulimit të sekretit shtetëror (ku akuzohej gazetari Lupço Zlatev), Piraterisë (ku pronari i portalit Infomax ishte i akuzuar) ose Spiuni (ku në mesin e të pandehurve ishte edhe gazetari Zoran Bozhinovski). Krahas këtyre krimeve, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me informacionin, ka edhe krime të tjera që kanë qenë objekt hetimi i Prokurorisë Speciale Publike, si rasti “Trevnik”, ku gazetari Dragan Pavloviç Llatas – redaktori televizionit Sitell i cili akuzohej për ndërtimin e një objekti pa leje, dhe rasti “Tifani” – ku gazetarja Ivona Taleska akuzohej për shpenzime të paarsyeshme nga buxheti i një personi juridik – gazetare redaktore në televizionin Sitell, i cili në periudhën 2008-2016 ishte i orientuar drejt Qeverisë.

Në pjesën për mundësinë e njohjes së SLAPP-eve, gjyqtari tha se kjo shihet nga akuza e ngritur nga prokuroria publike ose nga paditësi privat.

Ndryshe nga lëndët penale, të cilat në thelb janë SLAPP-e dhe të cilat nuk janë shumë të shumta, ekziston një mundësi më e madhe për një SLAP në procedurat civile për shpifje dhe fyerje. Në intervistën me gjykatësin civil është theksuar se ekziston një mekanizëm për parandalimin

e SLAPP përmes të ashtuquajturës “proceset gjyqësore nga inati”, por është delikate sepse ekziston rreziku i kufizimit të së drejtës së qytetarëve për qasje në gjykatë. Prandaj, duhet t’i kushtohet vëmendje mënyrës se si identifikohen rastet gjyqësore që do të kishin elemente të një SLAPP. Në pjesën e kompensimit të dëmit, gjyqtari civil theksoi se në praktikë gjyqtarët më shumë sjellin vendime për kërkim falje publike vetëm nëse bëhet fjalë për shpifje apo fyerje të vërtetuar, ndërsa në një numër të vogël rastesh jepet vendim për kompensimin e dëmit por kur shumat nuk janë të larta. Gjykatësi civil, në pjesën për kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, theksoi se gjykimet kanë mesatarisht 2 deri në 3 seanca dhe se ato përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

Në pjesën e zbatimit të kornizës juridike ndërkombëtare dhe kombëtare, gjykatësi theksoi se edhe më parë edhe tani, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje, gjykatësit munden dhe zbatojnë drejtpërdrejt Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si praktikë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në Akademinë për gjykatës dhe prokurorë janë krijuar module të veçanta për zbatimin e KEDNJ dhe praktikën e GJEDNJ për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve publikë.

Megjithatë, përkundër trajnimit dhe specifikës së çështjeve në të cilat gjykohen shpifja dhe fyerja, nuk ka ndonjë departament të veçantë apo formë tjetër në të cilën do të gjykonin gjykatës të specializuar për shpifje dhe fyerje.

Megjithatë, përkundër trajnimit dhe specifikës së çështjeve në të cilat gjykohen shpifja dhe fyerja, nuk ka ndonjë departament të veçantë apo formë tjetër në të cilën gjyqtarët e specializuar për shpifje dhe fyerje do të gjykojnë.

Krahas gjyqtarëve nga gjykatat themelore të Shkupit, janë zhvilluar intervista edhe me avokatët që më së shpeshti janë paraqitur si përfaqësues të gazetarëve të paditur dhe persona të tjerë pjesëmarrës në jetën publike në Maqedoninë e Veriut. Në bisedë, avokatët, por edhe gjyqtarët, theksuan nevojën për kujdes gjatë krijimit të mekanizmave të procesit për parandalimin e SLAPP në sistemin juridik të Maqedonisë. Juristët posaçërisht theksuan se ka presion veçanërisht të madh kur bëhet fjalë për gazetarët hulumtues, duke përmendur shembullin e Laboratorit të Gazetarëve Hulumtues - IRL, ndaj të cilit rastet gjyqësore po shumohen, vetëm për të kufizuar kërkimet e tyre, të cilat zbulojnë afera korruptive, jo vetëm brenda institucioneve shtetërore, por edhe në sektorin privat.

Avokatët theksuan se është e rëndësishme të ndiqet praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht për sa i përket Maqedonisë së Veriut, e cila duhet të inkorporohet në sistemin ligjor dhe gjyqësor. Në sferën e veprimeve të gjykatësve, avokatët theksuan se ka shumëllojshmëri në veprime, si dhe në vendimmarrje, në rastet e shpifjes dhe fyerjes, gjë që krijon pasiguri juridike, e cila mund të konsiderohet edhe si një avantazh për SLAPP.

Avokatët gjithashtu theksuan se është e nevojshme të shtohet edukimi i vazhdueshëm i gjykatësve për praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me theks të veçantë në SLAPP. Edukimi është mënyra më e thjeshtë për ta paraqitur SLAPP-et si një rrezik i fshehtë për të kufizuar pjesëmarrjen në hapësirën publike dhe informimin e mediave dhe gazetarëve, si dhe shoqatave qytetare dhe aktivistëve, kur kritikojnë tendencat dhe dukuritë negative që dëmtojnë drejtpërdrejt interesin publik.

Autorët e kësaj analize kanë biseduar edhe me gazetarë hulumtues të cilët janë të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj SLAPP-ve në punën e tyre të përditshme. Si parandalim i SLAPP-it, gazetarët besojnë se duhet të përdoret një seancë paraprake, ku gjykatësi mund të vlerësojë nëse bëhet fjalë për SLAPP apo për shpifje dhe fyerje të supozuar. Prandaj, gazetarët konsiderojnë se seanca përgatitore është pjesë e procedurës gjyqësore që gjykata e zhvillon më shumë formalisht se sa përmbajtësisht, sepse gjyqtarët nuk vlerësojnë nëse ka interes ligjor të paditësit për ngritjen e padisë.

Gazetarët, sikurse avokatët[26], vlerësojnë se duhet kushtuar një vëmendje e veçantë trajnimit për specializimin e gjykatësve për shpifje dhe fyerje, si rezultat i përvojës së tyre të mëparshme. Sistemi i krijuar, sipas të cilit të gjithë gjykatësit gjykojnë shpifjen dhe fyerjen, paraqet rrezik për pasigurinë juridike dhe cilësinë e vendimeve në këto raste specifike. Rrjedhimisht, gazetarët mendojnë se në gjykatat më të mëdha duhet të ketë një departament në të cilin do të ketë gjykatës të specializuar për shpifje dhe fyerje.

Po ashtu, gazetarët hulumtues deklaruan se ka nevojë të madhe për njohjen e publikut me kuptimin dhe rrezikshmërinë e SLAPP-ve, në mënyrë që të rritet presioni i publikut ndaj aktorëve që janë krijues të SLAPP-ve. Në të njëjtën kohë, u theksua se edhe njohja e publikut duhet të jetë në drejtim të kësaj, në mënyrë që ata të dinë se qëllimi i SLAPP është që gazetarët të heshtin ose së paku t'i censurojnë ata.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës dhe kompensimit të dëmeve, gazetarët theksuan se një pjesë e tyre mbulohen prej mediave të tyre, ndërsa shumicën e mbulon Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, e cila ofron mbështetje të veçantë në rastet gjyqësore.

Në fund, gazetarët theksuan se Këshilli i Evropës duhet të bëjë një angazhim të veçantë në mbrojtjen e gazetarëve nga SLAPP, duke rritur ndërgjegjësimin e njerëzve që jetojnë në shtetet anëtare. Është gjithashtu e nevojshme që Këshilli i Evropës të ofrojë udhëzime të qarta për parandalimin e SLAPP, si dhe edukimin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë për të njohur lehtësisht elementët e SLAPP, në mënyrë që të sigurohen kushte normale për pjesëmarrjen e gazetarëve në hapësirë publike dhe të punojnë në mbrojtjen e interesit publik.

26 Kodeks për Etikën Profesionale të Avokatëve, Bashkëpunëtorëve Profesional të Avokatëve, dhe Praktikantët të Odës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë, https://www.mba.org.mk/index.php/mk/akti/kodeks-etika?showall=1

8. KONKLUZA DHE GJETJE NGA INTERVISTAT E REALIZUARA

Sipas Raportit të Mapping Media Freedom për vitin 2022[27], për Maqedoninë e Veriut janë dokumentuar 11 paralajmërime që përfshijnë 11 individë ose media. Duke ndjekur trendin në të gjithë Evropën, shumica dërrmuese e këtyre rasteve kishin të bënin me raste të sulmeve verbale (9), duke përfshirë frikësimin, të ndjekur nga sulmet fizike (3) kundër punonjësve mediatik.

Zyrtarë publikë drejtuan ofendime dhe kërcënime verbale në adresë të gazetarëve, duke përfshirë ofendime ndaj gazetarëve maqedonas si grup, të cilët në Facebook u quajtën "prostituta" nga një deputet, në shenjë pakënaqësie me mbulimin mediatik të fillimit të negociatave për anëtarësim në BE, në korrik të vitit 2022. Kërcënim ka pasur edhe nga nga policia, e cila ka thirrur në pyetje një gazetare në lidhje me një artikull të botuar një muaj më parë. Gjithashtu, ka pasur edhe raste të tjera të tilla pas ankesës së një personi të cituar në shkrimin e gazetarit. Në të dyja rastet, individë të pakënaqur nga mbulimi mediatik, kanë arritur të kërcënojnë gazetarët nëpërmjet punonjësve të policisë, të cilët kanë ndjekur procedura të papërshtatshme. Paralajmërimi i tretë dokumenton sjelljen e pahijshme të një oficeri policie, i cili përfundoi duke dëmtuar kamerën e një gazetari televiziv. Katër gazetarë pësuan sulme të dhunshme fizike. Gazetarët që punojnë në televizion shpesh ofendohen dhe shtyhen. Situata e përgjithshme me mbrojtjen e punës gazetareske dhe presionet me të cilat përballen është në nivel të palakmueshëm. Prandaj, për të pasur një pasqyrë të plotë të procedurës SLAPP në Maqedoninë e Veriut, ekipi i ekspertëve zhvilloi një intervistë me dy (2) gjykatës penalë dhe katër (4) avokatë të cilët kanë përvojë në procedura të tilla.

9. REKOMANDIME PËR TRAJTIMIN E RASTEVE SLAPP, NGA ASPEKTI LEGJISLATIV DHE PRAKTIK

Ndër prioritetet duhet të jetë identifikimi dhe përcaktimi i treguesve përmes të cilëve njihet ekzistenca e SLAPP. Është pikënisja nga e cila do të ndërtohen politikat dhe do të krijohet legjislacioni.

9.1 Treguesit për identifikimin e SLAPP

Sipas gjithë asaj që thuhet në teori, praktikë, në vendime gjyqësore, precedentë dhe nocione të ndryshme të termit në vende të ndryshme, nuk është e thjeshtë të përcaktohen treguesit që

27 Media Freedom Rapid Response (MFRR), Mapping Media Freedom, Monitoring Report – 2022 https://www.mappingmediafreedom.org/wp-content/uploads/2023/02/MFRR-Monitoring-Report-2022.pdf

janë imanent për këtë fenomen. Sfida është, para së gjithash, se nuk ka një kufi të përcaktuar në mënyrë të qartë midis paraqitjes së një pretendimi për të drejtat e njeriut që synon në të vërtetë mbrojtjen e të drejtave personale të një personi ose të një personi juridik të caktuar, dhe atyre që janë të maskuar si të tillë, dhe kanë një qëllim krejtësisht të ndryshëm. Në mungesë të një përkufizimi legjislativ, për të gjetur emërues të përbashkët, duhet të shohim praktikën, vendase dhe ndërkombëtare.

Të njohësh paditë SLAPP nuk është detyrë e thjeshtë. Këshilli i Evropës, në draft-rekomandimin për kundërshtimin e përdorimit të SLAPP-it, tenton përmes një qasjeje të hapur dhe më të gjerë të përcaktojë treguesit për identifikimin e SLAPP. Megjithatë, përkundër kësaj, nuk është e lehtë të dallosh se çfarë është padi, pra një proces i nisur që synon realizimin e një interesi të ligjshëm juridik, me një qëllim legjitim dhe një pretendim legjitim, nga ai që synon qartë arritjen e vështirësive në funksionimin e të pandehurit dhe ato nuk janë prioritet.

Nga praktika, intervistat dhe përvojat e mbledhura, emëruesit e përbashkët të mëposhtëm mund të nxirren si tregues të padive SLAPP.

I.	Shpesh, këto lloj padish janë qartësisht të pabazuara, përmbajnë gjuhë fyese dhe maskohen si padi për shpifje ose shkelje të pretenduara të të drejtave kushtetuese dhe/ose civile, dhe zakonisht ngrihen kundër gazetarëve ose aktivistëve për ushtrimin e të drejtave të tyre politike dhe/ose lirinë e tyre të shprehjes dhe informimit në lidhje me çështje me interes publik ose me rëndësi shoqërore.
II.	Ato zakonisht nuk dorëzohen për të siguruar drejtësinë, por për të frikësuar, heshtur dhe shterur burimet financiare dhe psikologjike të objektivave të SLAPP, gjë që është e dukshme, sepse performanca është e tepruar, me një demonstrim të fuqisë së tepërt, punësimin e një numri të madh të këshilltarëve ligjorë, mediave, duke theksuar kërkesat e larta dhe të ngjashme.
III.	Ato zakonisht karakterizohen me një çekuilibër të madh të pushtetit midis paditësit dhe të padituri, ku njëri ka burimet dhe aftësinë për të heshtur efektivisht tjetrin nëpërmjet teknikave gjyqësore, të cilat rrisin barrën psikologjike dhe ekonomike të procedimeve të zgjatura.[28]
IV.	Lartësia e kërkesës, duke përfshirë nëse ekziston një rrezik real që do të pengojë pjesëmarrjen e publikut përtej çështjeve në fjalë;
V.	Natyra e tepruar ose e paarsyeshme e padisë ose e një pjese të saj, duke përfshirë por jo duke u kufizuar vetëm në kërkesat juridike që i kërkon paditësi;

28 Rafał Mańko Members' Research Service PE 733.668, SLAPP- BRIEFING EU Legislation in Progress, July 2023

VI.	Ekzistimi i një kërkese për masë të përkohshme, për ndalimin e transmetimit ose ritransmetimit të një hulumtimi, storjeje, libri ose të ngjashme.
VII.	Çdo disproporcion i identifikueshëm midis burimeve të përdorura nga paditësit dhe përfitimit të mundshëm legjitim për paditësin, nëse kërkesa ka sukses;
VIII.	Sjellja e paditësit në mosmarrëveshje përmes përdorimit të strategjive të zgjerimit, kërkesave të tepruara për dërgimin e të dhënave ose përdorimit të kërcënimeve agresive ligjore përpara fillimit të procedimit;
IX.	Çdo dështim për t'iu përgjigjur kërkesave të bëra me mirëbesim për koment përpara publikimit ose për të dhënë sqarime tregon natyrën SLAPP të atij procesi;
X.	Serioziteti i gjoja gabimit dhe madhësia e publikimit të mëparshëm;
XI.	Historia e kontesteve ndërmjet palëve dhe veprimeve të mëparshme të ngritura nga paditësi kundër palës ose të tjerë, kundër akteve te pjesëmarrjes publike;
XII.	Çdo refuzim pa argumentim të arsyeshëm për të zgjidhur çështjen përmes zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (me ndërmjetësim, arbitrazh, etj.);
XIII.	Veprime tangjenciale ose të njëkohshme në forume të tjera për të heshtur ose frikësuar fajtorët ose personat e lidhur;
XIV.	Çdo tipar që sugjeron se veprimi është ndërmarrë me qëllim ngacmimin, frikësimin ose në ndonjë mënyrë tjetër shtrëngimin e të pandehurit për të heshtur ose tërhequr.

9.2 Udhëzime të përgjithshme dhe rekomandime për mbrojtjen nga SLAPP

Edukimi i publikut rreth SLAPP. Kjo do t'i ndihmojë njerëzit të kuptojnë se çfarë janë SLAPP-et, si funksionojnë dhe si të mbrohen prej tyre.

- Rritja e ndërgjegjësimit për SLAPP në media. Kjo do të ndihmojë për të hedhur dritë mbi këtë çështje dhe për ta bërë një SLAPP më të vështirë për të pasur sukses.

- Trajnimi i profesionistëve ligjorë se si të identifikojnë dhe të përgjigjen ndaj SLAPP-ve. Kjo do të ndihmojë të sigurohet që viktimat e mundshme të SLAPP të kenë akses në ndihmën ligjore që u nevojitet.

- Fuqizimi i viktimave të mundshme SLAPP. Kjo mund të bëhet duke u ofruar atyre informacion rreth SLAPP-eve, duke i ndihmuar ata të lidhen me burimet ligjore dhe duke u ofruar atyre mbështetje emocionale.

- Forcimi i mbështetjes kundër-SLAPP. Kjo mund të bëhet duke kontaktuar zyrtarët e zgjedhur, duke i shkruar letra redaktorit dhe duke mbështetur organizatat që punojnë për të luftuar SLAPP.

HAPA KONKRETE QË DUHET TË NDËRMERREN NË TË ARDHMEN

Kuvendi, si organ legjislativ, në kuadër të kompetencave të tij, duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm për parandalimin e padive SLAPP kundër gazetarëve, si dhe aktivistëve që punojnë në segmentin e mbrojtjes së interesit publik.

Në një periudhë prej 6 deri në 18 muaj:

I.	Të ndërhyhet në projektligjin për procedurën civile, i cili është në proces miratimi, në drejtim të seancës përgatitore në LPC, për ta forcuar atë duke shqyrtuar mundësinë e vërtetimit të interesit ligjor në procedimin për fyerje dhe shpifje.
II.	Dispozitat për shpifje në Ligjin për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje duhet të rishikohen, në mënyrë që të sigurohet mbrojtje vetëm për deklarimet e rreme të fakteve dhe që shkaktojnë dëme të konsiderueshme në reputacionin e paditësit, ndërsa këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Nga ana tjetër, duhet të krijohen mekanizma mbrojtës që të mos keqpërdoren këto të drejta për informim, pra të vendosen mekanizma adekuate parandaluese.

Qeveria si propozuese e ligjeve, në kuadër të kompetencave të saj, duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm për parandalimin e padive SLAPP ndaj gazetarëve, si dhe aktivistëve që punojnë në segmentin e mbrojtjes së interesit publik:

Në një periudhë prej 6 deri në 12 muaj:

I.	Të parashikojë dhe të propozojë me ligj mekanizma kundër SLAPP,
II.	Të shqyrtohet mundësia e miratimit të një ligji të posaçëm, ku, ndër të tjera, do të vendoset një çmim tavan për madhësinë e kompensimit që mund të jepet për dëmin jo-material të imazhit - domethënë dëmin që nuk mund të llogaritet në terma monetarë. - por, nuk duhet të ketë një nivel minimal ligjor të kompensimit.

III.	Të propozohet vendosja ligjore e kritereve më të rrepta për vërtetimin e interesit ligjor në rastet që janë tregues të SLAPP.

Gjykatat, si një nga autoritetet që shpërndanë drejtësinë, në kuadër të juridiksionit të saj duhet të ndërmarrin hapat e mëposhtëm për parandalimin e padive SLAPP ndaj gazetarëve, si dhe aktivistëve që punojnë në segmentin e mbrojtjes së interesit publik:

I.	Krijimi i një praktike për shqyrtimin e mundësisë, kur bëhet fjalë për pretendimet ligjore në rastet e shpifjes dhe ofendimit, në lidhje me shumat, për të bërë dallimin midis veprimeve të të pandehurit me dashje, d.m.th. kur ai ka vepruar me dijeni për të pavërtetën e deklaratës dhe me qëllim të caktuar për t'i shkaktuar dëm paditësit, nga pakujdesia, dhe të zbatohet instituti i "gjykimit nga inati".
II.	Shuma e kompensimit të dhënë nuk duhet të jetë kurrë në disproporcion me dëmin e shkaktuar dhe duhet të marrë parasysh të gjitha mënyrat jo-materiale të kënaqësisë morale, siç është publikimi i një kërkim faljeje ose ushtrimi i së drejtës së përgjigjes, si dhe niveli i kompensimit që jepet në raste të tjera.
III.	Shuma e kompensimit të dhënë në çdo rast duhet të marrë parasysh aftësinë reale financiare të të pandehurit.
IV.	Njohja e natyrës funksionale të gazetarisë duhet të forcohet. Jo vetëm gazetarët, por edhe të gjithë personat e tjerë fizikë dhe juridikë, të cilët rregullisht ose profesionalisht angazhohen në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit për publikun, nëpërmjet çdo mjeti të komunikimit masiv, ose bëjnë analiza, raportime, kërkime që ndërhyjnë në interesat publike të komunitetit më të gjerë, duhet të vihen nën ombrellën e mbrojtjes nga SLAPP.
V.	Në rastin e një SLAPP, dëmtimi i imazhit të një personi duhet të arrijë një prag të caktuar rëndësie përpara se të justifikojë një kufizim të lirisë së shprehjes; konkretisht, duhet të shkaktojë "dëm serioz".
VI.	Në vlerësimet e tyre për çështjet e ngritura nga zyrtarë publikë, politikanë dhe personazhe publike, gjykatat duhet të pranojnë se këta persona duhet të kenë një tolerancë më të madhe ndaj kritikave sesa qytetarët e zakonshëm, pasi janë të përfshirë drejtpërdrejt në çështje me interes publik.
VII.	Në vlerësimin e rasteve, gjykatat duhet të sigurojnë që askush të mos jetë përgjegjës për shpifje për shprehjen e një mendimi. Gjykatat duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat e një deklarate, duke përfshirë gjuhën dhe zhanrin e përdorur, kur vlerësojnë nëse një deklaratë është opinion. Aty ku duket qartë se një deklaratë nga audienca kuptohet se është bërë me një ton humoristik, provokues ose satirik, duhet të konsiderohet një opinion.

Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, pika e vetme hyrëse në gjyqësor, përmes trajnimeve bazë dhe ofruese të edukimit të vazhdueshëm ligjor, të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

Në një periudhë prej 6-12 muajsh:

I.	Përgatitja e kurrikulave përmes të cilave do të prezantohet trajnimi për përmirësimin e kapaciteteve të gjyqësorit për të zbatuar standardet ndërkombëtare dhe rajonale për lirinë e shprehjes në rastet e shpifjes dhe padive strategjike, në veçanti praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet në këto gjykime.
II.	Përgatitja e kurrikulave të trajnimit për zbatimin e kritereve më të rrepta për vërtetimin e interesit ligjor në rastet që kanë tregues SLAPP.

10. SHTESË

(1) Ali Ahmeti kundër ATV Media Company DOOEL Shkup dhe Isen Saliu - Aktgjykimi P5-17/18 i datës 25.09.2018 i Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup dhe Aktgjykimi GZH-57/19 i datës 13.02.2019 nga Gjykata e Apelit Shkup.

(2) E Majta kundër Xhabir Derallës - Aktgjykimi P5-4/19 i datës 26.11.2019 i Gjykatës Themelore Civile dhe Aktgjykimi GZH-819/20 i datës 9.6.2020 i Gjykatës së Apelit Shkup.

(3) Milenko Nedellkovski kundër Mlladen Çadikovskit, Vlladimir Tevçevit dhe Dobrivoj Budimskit - Aktgjykimi P4-a-122/13 i datës 19.5.2015 i Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup dhe Aktgjykimi GZH-822/16 i datës 17.11.2016 të Gjykatës së Apelit Shkup.

Shoqata e Gazetarëve
të Maqedonisë